



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:164804

Datë: 09.10.2024

Numri i dokumentit: 06284555

P.nr.1031/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Dardane Ismaili me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Musliu Bekteshi në lëndën penale kundër të pandehurit A.T. për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.4436/18 e datës 29.11.2018, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, me datë 09.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë me numër PP.II.nr.4436/18 e datës 29.11.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

A.T. nga i ati F...,e ëma Sh...,e vajzërisë A..., i lindur me datë ..., me adresë të vendbanimit Rr. "...",Mitrovicë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,me numër personal ..., për veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale që ka arritur me datë 23.09.2021.

II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

III. Pala e dëmtuar, S.M. nga Mitrovica, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.4436/18 e datës 29.11.2018 kundër të pandehurit A.T. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e ka pranuar këtë lëndë më datë: 02.09.2024 dhe pas ndërmarrjes së veprimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se në këtë çështje ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas aktakuzës, i pandehuri është akuzuar se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së për të cilën vepër është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

Neni 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të KPRK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar dy (2) vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim. Ndërkaq, sipas nenit neni 107 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafit 8 përcaktohet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata, nga gjitha faktet dhe provat e lartcekura konstaton se me datë 23.09.2017 kur dyshohet se i pandehuri A.T. ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së për këtë vepër penale kanë kaluar më tepër se katër (4) vite, që nënkupton se duke u bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur me datë 23.09.2021, ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të KPRK-së.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër për të cilën është akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka marr aktvendim me të cilin e ka hedhur aktakuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Aktvendimi mbi parashkrimin absolut është bazuar në kuptim të nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPPK-së, si dhe neni 358 të KPP-së, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së, ku është paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata ka vendosur që të dëmtuarin ta udhëzoj që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil, në bazë të nenit 463 paragrafi 3 të KPP-së, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktvendimi

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, sipas nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 1 dhe 8 të KPRK-së, e në mbështetje të nenit 358 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1031/2018, datë 09.10.2024

Gjyqtarja
Dardane Ismaili

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.